# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.

**AKT- THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **"ZGT Maintenance & Cleaning"**, zoterohet nga ortaket:

1. Individi **Z. Gentian Shabanaga**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. Personal I00106043B, i datelindjes 06.01.1980, lindur dhe banues neTiranë.
2. Individi **Z. Elton Sopiqoti**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr Personal H80614149C, i datelindjes 14.06.1978 , lindur ne Vlorë dhe banues ne Tiranë.
3. Individi **Z. Sazan Gorishova**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. Personal 100314140T, i datelindjes 14.03.1980, lindur ne Vlorë dhe banues ne Tirane.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosen të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

## NENI 1
## FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SHPK dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar.
Emri i shoqerise **"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.**

## NENI 2
## BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

## NENI 3
## SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rr "Komuna e Parisit", nr. pasuarie 6/442-N18, Zona kadastrale 8260, Njesia Administrative nr. 5, Tirane, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

## NENI 4
## KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

## NENI 5
## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria "ZGT Maintenance & Cleaning" sh.p.k eshte e organizuar ne formen e nje shoqerie qe merret me:

**1.** Pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme: Përfshirë pastrimin e korridoreve, ashensorëve, shkallëve, fasadave dhe zonave të përbashkëta në ndërtesat rezidenciale apo komerciale.

**2.** Menaxhimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave: Përfshirë administrimin e përditshëm, inspektimet e rregullta dhe organizimin e shërbimeve të riparimit (elektrik, hidraulik, etj.).

**3.** Pastrimi i dritareve dhe fasadave të ndërtesave: Shërbime të specializuara për pastrimin e sipërfaqeve të jashtme, duke përdorur pajisje dhe teknika të përshtatshme për sigurinë dhe pastërtinë.

**4.** Shërbimet e mirëmbajtjes së gjelbërimit dhe oborreve: Përfshirë kujdesin për hapësirat e gjelbra, oborret, kopshtet, dhe zonat rreth ndërtesave.

**5.** Pastrimi pas ndërtimit apo rinovimeve: Shërbime të dedikuara për pastrimin e ndërtesave të reja apo të rinovuara, duke përgatitur ambientet për përdorim të mëtejshëm.

**6.** Dezinfektimi dhe sanitizimi: Shërbime për higjienën e thellë dhe dezinfektimin e ambienteve të përbashkëta në banesa apo zyra.

7. Shërbimi Car Ëash: Përfshirë pastrimin profesional të automjeteve, brenda dhe jashtë, duke përdorur pajisje dhe solucione të specializuara për mbrojtjen e sipërfaqeve të automjeteve.

8. Importi dhe tregtimi i solucioneve dhe aksesorëve për pastrim: Përfshirë shitjen e produkteve për pastrim dhe mirëmbajtje, si solucione, detergjentë dhe aksesorë të tjerë të nevojshëm për klientët individualë dhe për kompanitë.

9. Çdo aktivitet tjetër tregtar, industrial, financiar, mobiliare dhe immobiliare i nevojshëm ose i dobishëm për arritjen e qëllimeve të shoqërisë, të lidhura direkt ose indirekt me veprimtaritë e përmendura më sipër.

10. Shoqëria mund të marrë gjithashtu pjesë në shoqëri ose ndërmarrje të tjera që kanë objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, si dhe të kryejë të gjitha operacionet mobiliare, immobiliare, tregtare dhe financiare të cilat konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të saj.

## NENI 6
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 10,000 (dhjetë mijë) lekë, i ndare në 3 (tre) pjese (kuota).
Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. **Individi Z. Gentian Shabanaga,** i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. Personal I00106043B, i datelindjes 06.01.1980, lindur ne Tiranë dhe banues ne Tiranë, zoterues i 1(nje) kuote ne vleren 3,400 (tremijë e katërqind) leke e cila perben 34% (tridhjete e kater per qind) te kuotave te kapitalit.

2. **Individi Z. Elton Sopiqoti**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr Personal H80614149C, i datelindjes 14.06.1978, lindur ne Vlorë dhe banues ne Tiranë, zoterues i 1(nje) kuote ne vleren 3,300 (tremijë e treqind) leke e cila perben 33% (tridhjete e tre per qind) te kuotave te kapitalit.

3. **Individi Z. Sazan Gorishova**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. Personal 100314140T, i datelindjes 14.03.1980, lindur ne Vlorë dhe banues ne Tirane, zoterues i 1 (nje) kuote ne vleren 3,300 (tremijë e treqind) leke, e cila perben 33% (tridhjete e kater per qind) te kuotave te kapitalit

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

## NENI 7
## AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

## NENI 8
## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise **"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.
Administrator i shoqerise per nje periudhe 5 (pese) vjeçare është emeruar:

1. **Z. Gentian Shabanaga**, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. Personal I00106043B, i datelindjes 06.01.1980, lindur ne Tiranë dhe banues ne Tiranë.

## NENI 9
## DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane. Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater ) ekzemplare ne gjuhen shqipe duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane, me 11.10.2024**

**ORTAKET E SHOQERISE**

**"ZGT Maintenance & Cleaning" Sh.p.k.**

**Gentian SHABANAGA**

**Elton SOPIQOTI**

**Sazan GORISHOVA**